



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 454 Prot.

Tiranë, më 11. 03. 2020

V E N D I M

Nr. 31, Datë 11/03/2020

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”¹, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 15, datë 27.02.2020, e z. Th.Z., ku pretendohet për diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar”, nga ana e Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë² dhe/ose Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Pas shqyrtimit fillestar të ankesës së mësipërme, Komisioneri³,

K O N S T A T O I:

Mbështetur në informacionin që përmban formulari i ankesës, si dhe referuar dokumentacionit bashkëlidhur, rezulton se z. Th.Z. ka depozituar pranë Komisionerit, kërkesën e datës 31.01.2020, nëpërmjet së cilës kërkon informacion mbi rastet kur, KMD është shprehur me vendime diskriminimi, mbi problematikën e mosrimbursimit të karburantit dhe lubrifikantëve të individëve me aftësi të kufizuar. Në përgjigje të kërkesës së tij, KMD i ka dërguar z. Th.Z. shkresën nr. 298, datë 19.02.2020, bashkëlidhur së cilës i ka përcjellë për dijeni Rekomandimin nr. 589, datë 15.06.2015 “Për marrjen e masave për eliminimin e situatës diskriminuese në lidhje me trajtimin me karburant dhe lubrifikantë të personave me paraplegjikë dhe tetraplegjikë” drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Pas marrjes dijeni mbi këtë Rekomandim të Komisionerit, Z. Th.Z. depozitoi ankesën nr. 15, datë 27.02.2020, ku pretendohet për diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar”, nga ana e Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë dhe/ose Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Në vijim, z. Th.Z. sqaron se është invalid para dhe tetraplegjik dhe ka në pronësi të tij autoveturën me nr. shasie WOL000078v42322271, e cila në vitin 2013, i është nënshtruar procedurës së zhdoganimit, duke u përjashtuar nga detyrimi doganor⁴. Ankuesi pretendon se në kushtet, kur ai është person me aftësi të kufizuara, ka kërkuar rimbursim të karburantit dhe

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

² Aktualisht Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

³ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

⁴ Referuar Vërtetimit nr. 75/1, datë 30.01.2013, të Shërbimit Social Shtetëror.

lubrifikantit pranë Shërbimit Social Shtetëror. Ky institucion e ka informuar se një gjë e tillë është në kompetencë të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Në vijim, z. Th.Z. i është drejtuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Dega Sarandë, me kërkesën nr. 22.02.2013, nëpërmjet së cilës i kërkon rimbursimin e shpenzimeve të blerjes së karburantit dhe lubrifikantit. Nëpërmjet shkresës nr. 381/1, datë 14.03.2013, ISSH, Dega Sarandë e ka bërë me dije z. Th.Z., se ai nuk përfiton rimbursim të shpenzimeve të blerjes së karburantit dhe të lubrifikantit.

Për sa më sipër, ankuesi ka depozituar ankesë pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Vlorë. Me vendimin nr. 109, datë 16.09.2013, të Komisionit Rajonal të Ankimit, pranë DRSSH Vlorë, kërkesa ankimore e z. Th.Z., mbi rimbursimin e karburantit dhe lubrifikantit është rrëzuar.

Ankuesi ka paraqitur ankim administrativ nr. 5617, datë 01.07.2013 pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore, i cili i ka kthyer përgjigje nëpërmjet shkresës nr. 5617/2, datë 01.07.2013, ku e sqaron se kërkesa e tij nuk përbën objekt shqyrtimi për Komisionet e Ankimit, të parashikuar nga neni 86, pika 1 dhe 2 të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë (i ndryshuar).

Në këtë kontekst, z. Th.Z. pretendon se në kushtet, kur ai nuk ka përfituar rimbursim për shpenzimet e karburantit dhe lubrifikantit, nga viti 2013 e në vijim, ai është diskriminuar për shkak të aftësisë së kufizuar nga subjektet e sipërpërmendura.

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 15, datë 27.02.2020, së Z. Th.Z., KMD konstatoi se:

Në ankesën nr. 15, datë 27.02.2020, së z. Th.Z. pretendohet për diskriminim për shkak të “aftësisë së kufizuar”, nga Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë⁵ dhe/ose Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Nga analizimi i provave shkresore të depozituara nga ankuesi rezulton se të gjitha veprimet e kryera nga ana e tij, si dhe të gjitha përgjigjet shkresore të institucioneve respektive kanë ndodhur në vitin 2013. Njëkohësisht, Komisioneri konstatoi se në formularin e ankesës, ankuesi ka deklaruar se diskriminimi i tij ka ndodhur në datën **30.01.2013**.

Në nenin 33, pika 4, gërma dh), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 parashikohet se ankesa nuk pranohet, nëse paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se një vit nga marrja dijëni nga i dëmtuari, për këtë fakt. Referuar formularit të ankesës rezulton se diskriminimi i pretenduar ka ndodhur në datën **30.01.2013**, ndërkohë që ankesa e tij është depozituar pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në datën **27.02.2020**, pra 7 vite më vonë, nga ndodhja e diskriminimit.

Në formularin e ankesës, z. Th.Z. ka shënuar se ka marrë dijëni për diskriminimin e tij, në datën **23.02.2020**, pasi në këtë datë është njohur me Rekomandimin nr. 589, datë 15.06.2015, i KMD-së, “Për marrjen e masave për eliminimin e situatës diskriminuese në lidhje me trajtimin me

⁵ Aktualisht Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

karburant dhe lubrifikantë të personave me paraplegjikë dhe tetraplegjikë” që i është dërguar ish-Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se momenti i marrjes dijeni për diskriminimin e ndodhur përkon me periudhën kohore, përgjatë së cilës ankuesi ka kryer korrespondencë zyrtare me institucionet përkatëse dhe jo me datën e marrjes dijeni me Rekomandimin të sipërpërmendur. Komisioneri ka konstatuar se në vijim të njohjes me përmbajtjen e këtij Rekomandimi, ankuesi nuk ka kryer asnjë veprim për të kërkuar të drejtën e tij për rimbursim të shpenzimeve të karburantit dhe lubrifikantëve pranë institucioneve kompetente, si dhe të njihej me përgjigjen e tyre, zyrtare.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 7, 12, 13, 20, 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), nenin 33, pika 4, gërma dh), si dhe në nenin 36, pika 1, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës nr. 15, datë 27.02.2020, e Z. Th.Z., pasi ankesa e tij është depozituar tej afateve ligjore pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Robert GAJDA

KOMISIONER

Fusha – sherbime
Shkak – aftesi e kufizuar